

REPUBLICA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E FERIZAJIT • OPSTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ  
- HISTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA

Data / Datum: 26/07/2024		
Nr. Prot. / Br. Prot. 01	Nr. Prot. / Br. Prot. 229	Nr. Faqeve. / Br. Strana. 3

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA



Bazuar në dispozitat e nenit 16 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike 03/L – 087, si dhe nenit 8 të Statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale, si dhe Ligji për ndryshim dhe plotësim për Ndërmarrje Publike 05/L-009 të nenit 6. Komisioni Komunal i Aksionarëve i Ndërmarrjes Publike Lokale “Ambienti” Sh.A. në Ferizaj shpall:

**Nr.229 /24**

**Datë: 26.07.2024**

## KONKURS

Për zgjedhjen e 4 (katër) anëtarëve në Bordin e Drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. në Ferizaj.

Mandati i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të zgjedhur është 3 ( tre) vite.

Procedura e konkursit është e hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

## KUALIFIKIMI DHE PËRGATITJA PROFESIONALE

Sipas nenit 17, të Ligjit 03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, si dhe Ligjit për ndryshim plotësim për Ndërmarrje Publike 05/L-009 të nenit 6, kandidatët për tu zgjedhur anëtar në bordin e drejtorëve duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të kenë përgatitje universitare,
- Të posedojnë aftësi dhe shkathtësi profesionale,
- Të kenë aftësi për të kryer detyrat e punës në situatë të qetë dhe nën presion.

## KRITERET

Kandidatët të cilët do të zgjedhen anëtarë në Bordin e Drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Lokale “Ambienti” Sh.A, duhet:

- Të mos kenë bërë shkelje të Kodit Etik për standardet e sjelljes profesionale

## **Kandidatët nuk mund të zgjedhen anëtarë në Bordin e Drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Ambienti" Sh.A :**

- Nëse aktualisht është zyrtarë/e, menxher i ndërmarrjes përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj,
- Nëse ka shërbyer si menaxher i ndërmarrjes publike përkatëse ose filialet e saj brenda 5 viteve të kaluara,
- Nëse aktualisht ka qenë ose gjatë tre viteve të kaluara ka pasur çfarëdo marrëdhënie afariste me ndërmarrjen publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë,
- Nëse është aksionar, drejtor ose zyrtarë i një shoqërie tregtare ose person tjetër juridik, i cili ka marrëdhënie materiale, afariste me ndërmarrjen publike përkatëse,
- Nëse pranon ose ka pranuar brenda tre viteve të kaluara kompensimin shtesë nga ndërmarrja publike përkatëse ose cilëndo filial të saj ( përveç honorarit të drejtorit ose kompensimin stimulues të përcaktuar me nenin 20. 1 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike ose është anëtarë/e në skemën personale të ndërmarrjes publike përkatëse ose të cilëndo nga filialet e saj).
- Nëse përfaqëson një aksionar/e i cili posedon me mbi 10% të aksioneve votuese në ndërmarrjen publike përkatëse,
- Nëse ka shërbyer në bordin e drejtorëve të ndërmarrjes publike përkatëse më shumë se 9 vite, nga dita e zgjedhjes së tij,
- Nëse është zyrtar, drejtor ose aksionar ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare që konkurren me ndërmarrjen apo është menaxher i lartë zyrtar, drejtor ose aksionar i cili posedon me më shumë se 2 (dy) % të të drejtave të votimit, përkatësisht nëse ka një interes të konsiderueshëm financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare që konkurrojnë në ndërmarrjen publike,
- Nëse gjatë periudhës 36 mujore para datës së aplikimit, ka qenë zyrtar i zgjedhur, i emëruar politik ose bartës i postit udhëheqës apo vendim marrës në një parti politike,
- Nëse ka çfarëdo konflikti të interesit që për nga natyra do të ndikonte që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë efektive, me besnikëri në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbush detyrat me përgjegjësi ndaj aksionarëve dhe ndërmarrjes publike.

### **KUSHTET PËR APLIKIM**

Kandidatët të cilët konkurrojnë për anëtar në Bordin e Drejtorëve në "Ambienti" Sh.A. në Ferizaj duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Dëshmi për kualifikimin profesional,
- CV-në,
- Letër motivimi,
- Certifikatën e lindjes,
- Certifikatën që nuk është nën hetime,
- Deklaratën nën betim (formular i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit).

Aplikuesit duhet të nënshkruajnë deklaratën nën betim, në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësinë dhe përgatitjen profesionale. Çdo përgënjeshttrim material, qoftë

i qëllimshëm apo neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër përmendur, do të rezultoj me diskualifikimin e menjëhershëm.

**Formulari merret dhe dorëzohet në Qendrën për Shërbime të Qytetarëve, sporteli nr. 1, Komuna e Ferizajt. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur.**

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet jo të plota refuzohen.

**Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në web faqen zyrtare të Komunës së Ferizaj, në tabelën e shpalljeve, përkatësisht 26.07.2024 – 10.08.2024.**

Kryesuesi i Komisionit të Aksionarëve

Sh.A"Ambienti"



*Erver Bajrami*  
Erver Bajrami